



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 gusht 2012
Nr. ref.: 292/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI13/11

Parashtrues

Jeton Salihu dhe Mentor Salihu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë,
P.nr. 211/06 të 1 nëntor 2007, të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Ap.nr. 48/2008, të datës 14 maj 2008 dhe të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës Pzd. nr. 118/2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare.

Parashtruesit

1. Parashtruesit janë Jeton Salihu dhe Mentor Salihu nga fshati Durar i komunës së Vushtrrisë, të përfaqësuar nga avokati i tyre Mahmut Halimi nga Mitrovica. Parashtruesit janë vëllezër.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës, P.nr. 211/06, të datës 1 nëntor 2007 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Ap.nr. 48/2008, të datës 14 maj 2008.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me dënimin e parashtruesve për vrasje të Nexhat Mehollit të 31 dhjetorit 2005 dhe dëmtime të lehta trupore ndaj Berat Mehollit në po të njëjtën datë. Dënimi i parashtruesve kishte datën 1 nëntor 2007. Në të njëjtën datë babai I parashtruesve, Salih Salihu, ishte dënuar për dëmtime të lehta trupore ndaj Nexhat Mehollit dhe Berat Mehollit.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe Rregulli 56 (2) të Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 shkurt 2011, parashtruesit paraqitën një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 15 shkurt 2011 Salih Salihu, babai i parashtruesve, përcjelli në Gjykatë dokumentet në lidhje me dënimin e tij.
7. Më 2 mars 2011, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese caktoi gjyqtaren Ilirana Islami gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë Kryetari caktoi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodriguez dhe Kadri Kryeziu.
8. Me letren e datës 11 korrik 2011, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë informata që kanë të bëjnë me kërkesën. Gjykata e Qarkut në Mitrovicë u përgjigj më 19 korrik 2011, e cila përgjigje u pranua në Gjykatë më 22 korrik 2011.
9. Më 19 qershor 2012 Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit Raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përshkrimi i fakteve të rastit të evidentuara prej dokumenteve të ofruara nga parashtruesi

10. Më 1 nëntor 2007 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P.nr. 211/06 gjeti parashtruesin fajtor për vrasje sipas nenit 146 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës dhe fajtor për sulm sipas nenit 153, par. 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Gjykata dënoi parashtruesin Mentor Salihu me dënim të përgjithshëm prej dhjetë vjetësh e tre muajsh. Gjykata dënoi parashtruesin Jeton Salihu me një burgim të rëndë prej tetë vjetësh dhe dy muajsh. Babai i tyre gjithashtu ishte paraburgosur të njëjtën ditë për sulm.
11. Parashtruesit paraqitën ankesa të ndara për atë dënim në Gjykatën Supreme. Në ankesat e tyre parashtruesit pretendonin shkelje themelore të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe dënime tepër të rënda.

12. Më 14 prill 2008 Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Ap.nr. 48/2008 hodhi poshtë të dy ankesat si të pabazuara.
13. Më 10 nëntor 2008, një nga parashtruesit, Mentor Salihu, parashtroi një kërkesë për shqyrtim të procedurave penale në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe propozoi që të mblidhen dhe të shqyrtohen fakte të reja. Parashtruesi bazoi këtë kërkesë fillimisht në pretendimin se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka bazuar aktgjykimin e vet në vendosjen e gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike.
14. Më 27 dhjetor 2008 parashtruesit dorëzuan një kërkesë të bashkuar për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Kërkesa pretendonte shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurave penale, shkelje të ligjit penal dhe shkelje të nenit 157.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.
15. Më 3 shkurt 2009, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë në aktgjykimin Kp. Nr. 175/08 hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e Mentor Salihut për shqyrtim të procedurës penale.
16. Më 20 maj 2010 Gjykata Supreme në aktgjykimin Pkl. Nr. 40/90 hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë.
17. Më 14 dhjetor 2010 Gjykata Supreme në aktgjykimin Pzd. Nr. 118/2010 hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e përbashkët të parashtruesve për zbutjen e jashtëzakonshme të ndëshkimit.

Shkeljet e pretenduara kushtetuese

18. Parashtruesit pretendojnë shkelje të nenit 24[Barazia para Ligjit], neni 30 [e Drejta e të Akuzuarit], neni 31 [e Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6- e Drejta për Gjykim të Drejtë- të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

19. Parashtruesit pretendojnë se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka shkelur Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, është përfshirë në vendosjen e gabuar dhe jo të plotë të situatës faktike, ka shkelur ligjin penal dhe ka shqiptuar dënime tepër të rënda. Si rezultat parashtruesit pretendojnë se të drejtat e tyre Kushtetuese të garantuara me nenin 24, 30, dhe 31 të Kushtetutës ishin shkelur nga Gjykata e Qarkut e cila konfirmoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Fokusi i argumentit ligjor të parashtruesit është neni 157.1 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.
20. Në esencë, ata deklarojnë se dënimi i tyre ishte bazuar vetëm në dëshminë e Berat Mehollit dhe ata pohojnë se një gjykatë nuk mund të deklarojë një të akuzuar fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

21. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës
22. Neni 113 pika 1 dhe 7 i Kushtetutës vendos /rregullon kornizën ligjore të nevojshme për pranueshmëri. Përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi ti kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

23. Për më tepër, neni 48 i Ligjit thekson:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”

24. Përfundimisht, Rregulli 36 i Rregullores së Punës thekson:

“1. Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) Kërkesa është qartazi e bazuar.

2. Gjykata mund të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:

a) Kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

c) kur Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij;”

25. Siç u diskutua më sipër, parashtruesit pretendojnë se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka bërë shkelje të ndryshme të procedurës penale dhe ligjit penal, dhe në veçanti fokusohet në nenin 157.1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.

26. I tërë neni 157 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës thotë si në vijim:

Neni 157

(1) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale

(2) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë ose duke i dhënë rëndësi vendimtare deklaratimit të dhënë nga i pandehuri në polici ose para prokurorit publik (neni 156, paragrafi 1 i këtij Kodi).

(3) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.

(4) Gjykata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues (nenet 298 deri te 303 i këtij kodi)

27. Parashtruesit pretendojnë se ishin dënuar duke u bazuar vetëm në dëshminë e Berat Mehollit. Ata nuk ofrojnë ndonjë provë në kërkesën e tyre se ata ose avokatët e tyre nuk ishin në gjendje të marrin në pyetje Berat Mehollin ose në ndonjë mënyrë tjetër të kontestojnë dëshminë e tij gjatë rrjedhës së procedurës penale.
28. Në fakt, procesverbali nga gjykimi në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë të datës 4 qershor 2007, veçanërisht avokatit publik të palës mbrojtëse i është dhënë mundësia të marrë në pyetje Berat Mehollin dhe më tej është regjistruar marrja në pyetje e Berat Mehollit nga avokati mbrojtës.
29. Gjithashtu, në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Gjykata veçanërisht thekson se “Gjykata gjithashtu mori parasysh mbrojtjen e të akuzuarit” (në këtë rast deklaratat e bëra nga parashtruesit e po ashtu edhe nga babai i tyre, për të cilat Gjykata konstaton se nuk ishin në përputhje).
30. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e vet Pkl. Nr. 40/09, të datës 20 maj 2010, shqyrtoi këtë ankesë të veçantë të parashtruesve. Gjykata Supreme vërejti në veçanti se provat e shqyrtuara nga gjykata përfshinin provat e ekspertëve të dhëna në gjykim në lidhje me dëmtimet e shkaktuara ndaj të vdekurve. Gjykata Supreme konsideroi se këto prova mbështesnin dëshmitë e dëshmitarëve dhe prandaj nuk kishte shkelje të nenit 157 të Kodit Penal të Kosovës.
31. Parashtruesit nuk i kanë mbështetur pretendimet e tyre ashtu siç kërkohet me Ligj dhe me Rregullore.
32. Siç theksohet nga Gjykata Kushtetuese në rastin nr. KI 06/09, parashtruesi X kundër Aktgjykimit nr. 215/2006 të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit nr. 741/2005 të Gjykatës së Qarkut, Aktgjykimit nr. 217/2004 të Gjykatës komunale:

“... Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është gjykatë e apelit për gjykatat tjera në Kosovë dhe nuk mund të intervenojë duke u bazuar në atë se gjykatat e tilla kanë dhënë vendime të gabuara ose kanë vlerësuar gabimisht faktet. Roli i Gjykatës është vetëm të sigurojë përputhjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe instrumenteve tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih mutatis mutandis, i.a., Akdivar v. Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D. 1996, R.J.D. 1996-IV, paragrafi 65)”.
33. Siç theksohet më tej në rastin nr. KI 06/09, parashtruesi X kundër Aktgjykimit nr. 215/2006 të Gjykatës Supreme, Aktgjykimit nr. 741/2005 të Gjykatës së Qarkut, Aktgjykimit nr. 217/2004 të Gjykatës komunale:

“Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund t’u shërbejë atyre si e drejtë të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih mutatis mutandis aktgjykimin GJEDNJ apel. Nr. 5503/02, Meztur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimin i 26 korrikut 2005).
34. Prandaj kërkesa duhet të hidhet poshtë si e pabazuar sepse është qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata pas seancës së këshillimeve më 19 qershor 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'i komunikohet parashtguesit të kërkesës, dhe
- III. Ky Vendim do të publikohet në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Kryesues i Kolegjit Shqyrtues


Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani